



# Raporti i parë nga monitorimi i raportimit mediatik për punën e Kuvendit

**shtator - dhjetor 2015**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Institute for Democracy  
Societas Civilis - Skopje

# Raporti i parë nga monitorimi i raportimit mediatik për punën e Kuvendit

(shtator - dhjetor 2015)

---

*Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim.*

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas Civilis” - Shkup (IDSCS) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikpamjet e Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim.*



Instituti për demokraci “Societas Civilis” Shkup (IDSCS) nga qershori i vitit 2014 e përcjell cilësinë e debatit në Kuvend. Monitorimi në ciklin e parë u zhvillua gjatë 10 muajve, përkatësisht nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015<sup>1</sup>. Nga shtatori i vitit 2015 monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së debatit parlamentar vazhdon i përkrahur nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe do të zgjas deri më dhjetor të vitit 2017.

Qëllimi i monitorimit të medieve është për të ardhur në njohuri se në të cilën masë mediet janë pjesë e procesit të deliberacionit në shoqërinë gjatë krijimit të politikave publike, përkatësisht se në çfarë mase opinionit më të gjerë i ja transmetojnë argumentet e shfaqura në debatet kuvendore.

Para jush është raporti i parë për raportimit mediatic për Kuvend që ka të bëjë me periudhën katërmujore prej 1 shtatorit deri më 31 dhjetor të vitit 2015. Raportet vijuese për raportimin mediatic do të botohen për periudha tremujore vëzhgimi.

## Rezime

- Kthyerja e opozitës në Kuvendin e ktheu s[ri]sh interesimin mediatic ndaj debateve parlamentare. Një pjesë e konsiderueshme (43%) e debateve të analizuar në të cilat përmendet Kuvendi kanë të bëjnë me debatet në seancat plenare dhe në komisionet.
- Deputetët janë burime më shpesh të përfaqësuara në informacionet e botuara në periudhën shtator – dhjetor të vitit 2015 (49%). Të dytat sipas përfaqësimit janë burime në të cilat hynë përfaqësues të jashtëm, politikanë dhe diplomatë të shteteve të tjera në Maqedoni (13%), ndërsa përfaqësuesit e partive politike janë në vendin e tretë (12%).
- Në informacionet e analizuar mediatike në këtë periudhë më të shpeshta janë informacionet në të cilat është përfshirë deputet nga vetëm një opion politik në Kuvendin (56%), se sa në të njëjtën kohë edhe nga pushteti edhe nga opozita (44%).
- Mediet më shpesh publikojnë informacione në të cilat si burime janë përfaqësuar deputetë nga opozita (31%), se sa nga pushteti (24%).
- Informacionet në të cilat në të njëjtën kohë janë theksuar edhe deputetë nga pushteti edhe nga opozita më shpesh kanë të bëjnë me debatet në seancat plenare dhe në seancat në komisionet kuvendore.
- Krahasuar me periudhën në vitin 2014, tani është zvogëluar përqindja e burimeve nga partitë politike , ndërsa është rritur përqindja e burimeve të cilat shënohen si “të tjera” në të cilat hynë përfaqësues të shteteve të tjera, nga Unioni Evropian dhe SHBA, ambasadorë në Maqedoni dhe përfaqësues në përfaqësitë e jashtme në negociatat politike dhe në përgjithësi kyçja e tyre në zgjidhjen e krizës.

---

<sup>1</sup> Cikli i parë i cilësisë së debatit dhe të raportimit mediatic u zhvillua në kuadër të projektit “Kuvendi nën thjerrëz. Përforsimi i debatit politik dhe i diskursit deliberativ” i financuar nga Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut – EIDHR dhe i bashkë-financuar nga IDSCS dhe IEKOB. Raportin e plotë për cilësinë e debatit në ciklin e parë të vëzhguar i cili e përfshiu periudhën nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015 është i qasshëm në linkun vijues: <http://idscs.org.mk/images/parliament-watchdog/rovovska-debata-mk.pdf>

- Informacionet e publikuara që kanë të bëjnë me Kuvendin më shpesh janë të struktura si raporte informative (53%) dhe si lajme të shkurtra në të cilat është paraqitur vetëm informacioni themelor për ngjarjen (30%).
- Mediet në gjuhën shqipe më shpesh publikojnë informacione për përmbajtjen e debateve kuvendore, ndërsa në mediet në gjuhën maqedonase shkon shumica e informacioneve në të cilat parlamenti vetëm përmendet, por jo në kontekst të diskutimeve, por në kontekst të gjendjes më të gjerë politike në shtetin dhe raportet midis partive.

## I. Konteksti politik

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Deputetët zgjedhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill të vitit 2014, partia Organizata e brendshme revolucionare maqedonase – Parti demokratike për unitet kombëtar maqedonas (VMRO – DPMNE) fitoi 61 deputet ndërsa partneri i tyre i koalicionit me të cilin e themeluan Qeverinë, Bashkimi Demokratik për integrim (BDI), fitoi 19 deputetë. Nga një deputet në Kuvendin fituan partitë e Opsionit qytetar për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja demokratike kombëtare (RDK). Deputeti i cili mandatin e vet e fitoi nga RDK edhe krahas vendimit të partisë që ta bojkotojë Kuvendin iu bashkëngjiti grupit të deputetëve të BDI-së. Deputeti i BDI-së, Zulfi Adili, në shtator paralajmëroi se e braktis grupin parlamentar dhe se do të vazhdojë të merr pjesë në punën e Kuvendit si deputet i pavarur. Me këtë grupi i deputetëve i BDI-së numëron 19 deputetë. Me atë, tani grupi i deputetëve i BDI-së numëron 20 deputetë. Më 8 maj partia Përtëritja demokratike për Maqedoninë (DOM) e cila ka një deputet (Liljana Popovska) në Kuvendin, vendosi ta braktis koalicionin pushtet-mbajtës. Në periudhën nga 20 qershori i vitit 2014 deri në fund të gushtit të vitit 2015, deputetët e koalicionit më të madh opozitar të udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), e cila në zgjedhjet fitoi 34 mandate, e bojkotoi punën e Kuvendit. Nga 1 shtatori i vitit 2015 deputetët e koalicionit të LSDM u kthyen në parlamentin dhe morën pjesë në punën e tij.

Partitë më të mëdha nga pushteti dhe opozita pas periudhës së vrullshme të krijuar pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në prill të vitit 2014 në të cilën u publikuan një varg skandalesh të ndërlydhura me përgjimin e paligjshëm dhe në të cilën ndodhën protesta, më 2 qershor me ndërmjetësim të komisionarit për zgjerim të UE Johanes Han arritën marrëveshje<sup>2</sup> për tejkalimin e krizës. Marrëveshja përmban një varg masash me afate konkrete të cilat duhet të ndihmojnë që të tejkalohet kriza politike e cila u zhvillua pas shpalljes së bisedave të përgjuara. Masat kanë të bëjnë me kthyerjen e opozitës në Kuvendin, organizimin e zgjedhjeve të reja parlamentare, dorëheqje të qeverisë aktuale, formimin e qeverisë në të cilën në resorë kyç do të emërtohen ministra nga opozita, reforma në legjislativin zgjedhor, themelimin e prokurorisë speciale publike me mandat që ti hetojë theksimet në incizimet e publikuara.

Ndërkohë, ekipi i ekspertëve i angazhuar nga Komisioni evropian i udhëhequr nga Rajnhard Pribe, drejtor i mëparshëm i Drejtorisë për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian përgatiti raport të detajuar për problemet në më tepër sfera. Raporti i bën vështrim sistemit gjyqësor, kontrollit të punës së shërbimeve të sigurisë, problemeve gjatë organizimit të zgjedhjeve, gjendjes në mediet dhe udhëzime për reforma në të gjitha këto fusha e qëllimi i kësaj është përmirësimi i gjendjes në të gjitha

---

<sup>2</sup> Marrëveshja në opinionin e fitoi emrin “Marrëveshja e Përzihos” sipas lagjes në Shkup në të cilën është e vendosur rezidenca e UE në të cilën u zhvilluan negociatat politike midis liderëve të katër partive më të mëdha politike në Maqedoni, VMRO – DPMNE, LSDM, BDI dhe PDSH.

fushat. Raporti i është dërguar Kuvendit dhe shërben si udhërrëfyes për zbatimin e reformave në sferat e theksuara.

Nga 1 shtatori opozita u kthye në Kuvendin dhe tani ai punon në përbërje të plotë. Në periudhën e monitoruar shtator – nëntor të vitit 2015 shumica në pushtet numëron 81 deputet, ndërsa opozita 42 deputet.

Sipas marrëveshjes, opozita në tetor morri disa poste ministrore në qeverinë e Gruevskit, si në ministrinë e punëve të brendshme dhe të punës e politikës sociale. Zëvendës ministra opozitarë janë vendosur në ministrinë për financa dhe atë të bujqësisë për ta kontrolluar punën e institucioneve kyçe shtetërore në periudhën e zbatimit të zgjedhjeve.

Partitë me disa zvarritje në negociatat të cilat zhvillohen midis grupeve të tyre të punës në Klubin e deputetëve me ndërmjetësim të lehtësuesit Piter Vanhoute i angazhuar nga UE dhe SHBA, i shkelën afatet të kontraktuara paraprakisht për zbatimin e reformave. Ende (gjendja në janar të vitit 2016) vijojnë negociatat për sferat jurisprudencë dhe mediet.

Sipas “Marrëveshjes nga Përzhino” qeveria e kryeministrit Nikolla Gruevski gjatë janarit të vitit 2016 duhet të parashtrijë dorëheqje dhe një qeveri kalimtare duhet të organizojë zgjedhje të reja parlamentare të cilat duhet të mbahen në prill të vitit 2016.

Deputetët në Kuvendin nga të dy opsionet politike pothuajse pa diskutim i pranuan vendimet e arritura në negociatat ndërpartiake jashtë nga Kuvendi. Në seancat kuvendore deputetët menjëherë i përkrahen dhe votuan vendimet e propozuara si themelimi i Prokurorisë speciale publike, zgjedhjen e prokurorit special publik, zgjedhjen e ministrave opozitarë, formimin e komisionit anketues për skandalin e përgjimit, emërtimin e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve.

## II. Metodologjia e hulumtimi

Monitorimi i medieve përfshin përcjellje të informacioneve të paraqitura në 10 medie kombëtare në të cilat deputetët dhe Kuvendi. Përcjellja i përfshin tekstet e botuara në gjashtë gazeta ditore nga të cilat katër janë në maqedonisht dhe dy në gjuhën shqipe. Nga kontributet televizive përcillen informacionet e transmetuara në emisionet qendrore informative në katër televizione kombëtare nga të cilat dy janë në gjuhën maqedonase, ndërsa dy janë në gjuhën shqipe. Me monitorimin janë përfshirë mediet vijuese:

### **Gazeta**

- Dnevnik
- Utrinski vesnik
- Veçer
- Sloboden pečat
- Koha
- Lajm

### **Televizione**

- Sitell
- Tellma
- Alsat-M
- RTM2 Programi në gjuhën shqipe

Në mediet e përmendura përcillen dhe analizohen informacionet në të cilat përmenden Kuvendi, deputetët dhe procedura ligjvënëse. Në çdo tekst veç e veç dhe në çdo kontribut televiziv analizohen

elementet kryesore përkatësisht zhanri, fokusi i informacionit, lloji, numri, pala dhe sheshtësia e burimeve

### III. Strukturë mediatike dhe gjuhësore e publikimeve


Struktura e përmbajtjeve mediatike të analizuara në periudhën shtator – dhjetor i vitit 2015 është si vijon:

**Sipas llojit të mediumit:** gazeta ditore 66%, televizione 34%

**Gjuha e publikimit:** shqip 51%, maqedonisht 49%

**Informacione në gazetat sipas gjuhës:** maqedonisht 59%, shqip 41%

**Informacione në televizionet sipas gjuhës:** shqip 71%, maqedonisht 29%



### IV. Gjetje nga monitorimi

- **Fokusi i informacioneve të publikuara**

Në periudhën e monitoruara prej 1 shtatori deri më 31 dhjetor janë analizuar 361 informacion në të cilin përmendet Kuvendi ose deputetët të publikuara në mediet e monitoruara. Analiza e këtyre përmbajtjeve vë në pah se mediet në këtë periudhë më shpesh publikojnë informacione të cilat kanë të bëjnë me debatin ose ngjarjet në seancat kuvendore. Në 23% të rasteve informacionet kanë të bëjnë me debatet në ndonjë nga komisionet kuvendore, ndërsa në 20% të debateve nga seancat plenare. Ky është dallim i konsiderueshëm nëse krahasohet me raportim mediatik në të njëjtën periudhë para një viti, përkatësisht në vitin 2014. Në periudhën shtator – dhjetor të vitit 2014 mediet më shpesh vetëm e përmendnin parlamentin në kontekst të krizës politike në vend dhe bojkoti i opozitës. Shumë më rrallë publikojnë informacione të cilat kanë të bëjnë me përmbajtjen e debateve kuvendore.


Ky ndryshim në pjesë më të madhe ka të bëjë me kthimin e opozitës në Kuvendin prej 1 shtatori dhe kanalizimi i krizës politike në parlamentin. Në Kuvendin në këtë periudhë u shqyrtuan dhe u votuan një pjesë e ligjeve të cilat buruan nga marrëveshjet politike për zgjidhje të krizës. Në të njëjtën kohë në foltoret e parlamentit u paraqit pjesa më e madhe nga konfrontimi politik i cili paraprakisht për shkak të bojkotit të opozitës e anashkalonte parlamentin. Për këtë flet edhe renë semantike nga

njëqind fjalët më shpesh të përdorura nga mediet në titujt dhe nën-titujt në gazetatat dhe në paralajmërimet e kontributeve televizive në të cilat përmendet Kuvendi.




Reja semantike prej 100 fjalëve më të shpeshta në titujt, nën-titujt dhe paralajmërimet në informacionet në mediet që kanë të bëjnë me Kuvendin.

Gjithashtu, në këtë periudhë u shtuan informacionet e publikuara në të cilat vihen në pah ndryshimet ose shlyerja e ligjeve ekzistuese ose hyrja në fuqi të ndryshimeve të reja ligjore. Të tilla janë 12% nga përmbajtjet e analizuar krahasuar me 4% në periudhën prej para një viti.




Nëse analizohet fokusi i informacioneve sipas gjuhës të medias i cili i ka publikuar rezulton se mediet në gjuhën maqedonase më shpesh kanë publikuar informacione në të cilat Kuvendi vetëm përmendet, por përmbajtja nuk ka të bëjë me punën e deputetëve por në ngjarje më të gjera politike dhe raporte në shtetin. Mediet në gjuhën shqipe, ndërkaq, më shpesh publikojnë informacione për diskutimin kuvendor, në seancat plenare dhe në seancat e komisioneve kuvendore.




- Numër dhe ana e burimeve**

Në një të tretën (33%) nga informacionet e identifikuara të publikuara në mediet në periudhën shtator – dhjetor të vitit 2015, e të cilat kanë të bëjnë me Kuvendin, është theksuar vetëm një burim. Në 29% janë theksuar dy burime, në 14% tre, ndërsa në 12% më tepër se tre burime. Në 11% nga informacionet nuk është theksuar asnjë burim.




Në pothuajse gjysmën (49%) nga informacionet e publikuara në këtë periudhë si burime janë theksuar deputetë në Kuvendin. Kjo është pak më tepër se sa në periudhën e njëjtë në vitin 2014 kur si burime u theksuan deputetët në 42% të informacioneve. Krahasuar me periudhën në vitin 2014, tani është zvogëluar përqindja e burimeve nga partitë politike, ndërsa është rritur përqindja e burimeve të cilat janë shënuar si “të tjera” në të cilat hynë përfaqësues të shteteve të tjera, të Unionit Evropian dhe SHBA, ambasadorë në Maqedoni i dhe përfaqësues të institucioneve të tjera të jashtme.




Nëse analizohet cilit opion politik në parlamentin i takojnë deputetët të cilët janë theksuar si burime në informacionet e analizuara rezulton se sërish në pjesën më të madhe, mediet publikojnë



informacione në të cilën është përfaqësuar deputet nga një opSION politik (gjithsej 55%). Kështu, në 31% të informacioneve janë përfaqësuar deputetë vetëm nga opozita, në 24% vetëm nga pushteti, ndërsa në 44% njëkohësisht edhe nga pushteti edhe nga opozita<sup>3</sup>. Krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2014 rezulton se do të ishte zvogëluar përqindja e informacioneve të publikuara në të cilat janë përfaqësuar vetëm deputetë nga pushteti, ndërsa është rritur përqindja e atyre në të cilat janë theksuar deputetë edhe nga pushteti edhe nga opozita.



Nëse analizohet përfshirja e deputetëve sipas fokusit të informacionit të publikuar rezulton se deputetët nga pushteti dhe nga opozita janë theksuar në të njëjtën kohë si burime më shpesh në informacione që kanë të bëjnë me debatet parlamentare në seancat plenare (55%) dhe në seancat e komisioneve (61%). Vetëm deputetët nga opozita janë me shpesh burime të informacioneve të cilat kanë të bëjnë me debatet të seancave plenare dhe komisionet kuvendore. Opozitarët gjithashtu janë burim më i shpeshtë në informacionet në të cilat Kuvendi vetëm përmendet (43%), ndërsa thelbi i informacioneve që kanë të bëjnë në përgjithësi me punën ose raportet në parlamentin (39%). Deputetët nga pushteti më shpesh janë theksuar si burime në informacionet që kanë të bëjnë me ngjarje të tjera që nuk janë të ndërlidhura me Kuvendin dhe me informacionet që kanë të bëjnë në hyrjen në fuqi ose shlyerje të ligjit të caktuar ose të ndryshimeve ligjore




### • Zhanri i informacioneve të publikuara

Nga informacionet e analizuar në të cilat përmendet Kuvendi të publikuara në mediet në periudhën shtator – dhjetor 2015, pjesa më e madhe janë të strukturuar në formë të raporteve informative nga ngjarjet. Të tilla janë 53% nga informacionet e publikuara. Në ato më shpesh vetëm transmetohen informacione për ngjarjet duke mos u bërë analizë ose duke mos hyrë në kontekstin më të gjerë të

<sup>3</sup> Në ciklin e parë të monitorimit në periudhën qershor 2014 deri në maj 2015 deputetët e zgjedhur nga opozita të cilat e bojkotuan kuvendin në monitorimin shënohen si deputetë.

ngjarjeve ose të jepet pasqyrë komparative (krahasuese) ose historike. Sipas karakteristikave të zhanreve në vend të dytë sipas përfaqësimit janë lajmet e shkurtra (30%) në të cilat vetëm theksohen informacionet themelore për ngjarjet. Mandej vijnë shkrimet në gazetat ose temat në televizionet (11%) në të cilat krahas elementeve informative janë përfaqësuar edhe elementet analitike. Vijnë komentet me 4% , ndërsa intervistat dhe analizat janë të përfaqësuara në mënyrë jo të konsiderueshme.



## Projekti Kuvendi nën thjerrëz

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz” është i financuar nga Agjencia zvicerane për përkrahje dhe zhvillim. Në pjesën e aktiviteteve përfshin monitorim 28 mujor të cilësisë së debatit kuvendor dhe monitorim të asaj se si mediet raportojnë për punën e Kuvendit.

Monitorimi i debatit kuvendor dhe i raportimit mediatic filloi në shtator të vitit 2015 dhe do të zgjas deri në dhjetor të vitit 2017 dhe do të përfshijë analizë dhe raportim për njohuritë e përfituara nga monitorimi në çdo tre muaj. Në periudhën e projektit do të përpilohen 9 raporte tremujore për cilësinë e debatit në parlamentin dhe 9 raporte tremujore për raportimin mediatic për punën e deputetëve. Në kuadër të projektit do të zbatohen dhe do të shpallen rezultatet e dy hulumtimeve në terren të opinionit publik për perceptcionet e qytetarëve për punën e Kuvendit.

Projekti paraqet vazhdimësi të projektit “Kuvendi nën thjerrëz përforsimi i debatit politik dhe diskursi deliberativ” i cili u financua nga Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut – IIDHR dhe u realizua në periudhën nga muaji shkurt i vitit 2014 deri në tetor të vitit 2015.



**Raporti i parë nga  
monitorimi i raportimit  
mediatik për punën e Kuvendit  
shtator - dhjetor 2015**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC**



**Institute for Democracy**  
Societas Civilis -Skopje